



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

MINISTRI

Nr. 323 Prot.

Tiranë, më 14.01. 2018

URDHËR

Nr. 16, datë 11.01.2018

PËR
LEGALIZIMIN E DOKUMENTEVE TË PËRFUNDIMIT TË SHKOLLIMIT TË ARSIMIT
PARUNIVERSITAR


Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe VKM nr. 134, datë 7.3.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit, dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Legalizimi i dokumenteve të përfundimit të shkollimit të arsimit parauniversitar të kryhet në QSHA.
2. Dokumentet e përfundimit të shkollimit të arsimit parauniversitar, që do të pranohen për legalizim në QSHA janë:
 - Dëftesa e arsimit bazë;
 - Diploma e Maturës Shtetërore;
 - Certifikata e notave të Maturës Shtetërore;
 - Dëftesa/t e klasës;
 - Diplomat e përfundimit të shkollave private të arsimit të mesëm të lartë të licencuar, të cilat mund të jenë të një institucioni të huaj ose të ngjashme me të.
3. Fotokopjet e dokumenteve do të pranohen vetëm të noterizuara.

4. Dokumentet që do të legalizohen do të vijnë me postë nga DAR/ZA-të përkatëse dhe pas legalizimit do të kthehen prapë në DAR/ZA. Legalizimi do të kryhet brenda 5 ditëve nga momenti i protokollimit në QSHA.
5. Dokumentet e shkollës së mesme para vitit 2011, të firmosen nga drejtori dhe sekretari/ja e shkollës. Vërtetësia e këtij dokumenti kryhet nga inspektori i ngarkuar nga titullari i DAR/ZA-së.
6. Për shtetasit që kanë përfunduar shkollimin pas vitit 2011, legalizohet vetëm dokumenti “Certifikatë e Maturës Shtetërore”.
7. Titullari i DAR/ZA-së është përgjegjës për vërtetësinë e firmës së drejtorit të institucionit arsimor, përmbajtjen dhe formën e dokumentit të lëshuar nga ky institucion.
8. Dokumenti që do të legalizohet duhet të ketë:
 - stemën zyrtare të Republikës së Shqipërisë si edhe foton e vulosur të personit (kur lëshohet vërtetim).
 - gjeneralitetet, ashtu siç janë shënuar në amzë (emri, atësia, mbiemri, datëlindja, vendlindja, si dhe numri i amzës dhe numri i regjistrimit të veçantë), pavarësisht se mund të ketë raste të ndryshimeve të emrit dhe mbiemrit (pas martesës).
 - lëndët të shënuara sipas planit mësimor të periudhës së përfundimit të shkollimit, kur shtetasi ka kryer studimet;
 - Para vitit 2006, provimet e përfunduara të shkollës së mesme, të emërtohen provimet e pjekurisë .
12. Verifikimi i autenticitetit të firmës dhe vulës së dokumenteve që do të legalizohen kryhet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.
13. Dokumentet legalizohen me vulën e QSHA-së dhe firmosen nga specialisti i Qendrës së Shërbimeve Arsimore, i ngarkuar me këtë detyrë nga Drejtori i Përgjithshëm i QSHA-së.
14. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Njësitë Arsimore Vendore dhe të gjitha institucionet arsimore publike dhe private.
15. Urdhri nr. 76, datë 19.02.2013 “Për legalizimin e dokumenteve zyrtare të arsimit parauniversitar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës” shfuqizohet.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

